



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 38 të Ligjit për Ndërtim nr. 04/L-110 dt. 31.05.2012, nenit 13 dhe 14 të Ligjit për Procedurën Administrative nr.02/L28 dt. 22.07.2005, nenit 17 paragrafi 1 pika "b","d" dhe "e" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-40 dt. 20.02.2008, dhe nenit 57 shkronja "c" të Statutit të Komunës së Prishtinës nr. 01-110-391 dt. 25.02.2010, duke vendosur sipas kërkesës së Habib Leci, Hasim Dërmaku, Jahir Ahmeti, Sebush Dërmaku, Hasan Dërmaku, Habim Dërmaku, Naim Murati, Qamil Hajrizi, Agron Stublla, Fadil Grajcevci, Feti Gashi dhe Hysen Hajdini nga Prishtina, me investitor "Pozhegu Brothers" nga Fushë Kosova, me nr.05-392-224207 dt. 05.09.2016, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, merr këtë:

V E N D I M

I. I LEJOHET pronarëve Habib Leci, Hasim Dërmaku, Jahir Ahmeti, Sebush Dërmaku, Hasan Dërmaku, Habim Dërmaku, Naim Murati, Qamil Hajrizi, Agron Stublla, Fadil Grajcevci, Feti Gashi dhe Hysen Hajdini nga Prishtina, me investitor "Pozhegu Brothers" përdorimi i objektit afarist banesor C11/A/1 në kuadër të bllokut urbanistik "C11" të Planit Rregullues "Mati 1" konkretisht në kuadër të pjesës së parcelave të bashkuara(nr.824/2,824/14,824/21,826/1,826/3,826/4,826/5,826/6,826/7,826/8,826/9,827/1,827/2,827/3,827/4, 830/17,830/18 dhe 830/19 ZK Matiçan) të bllokut "C11" të ndërtuara sipas Aktvendimit nr. 05-351-32959, dt. 01.10.2012 të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit e Komunës së Prishtinës.

II. Objekti do të përdoret dhe shfrytëzohet sipas destinimit të caktuar me leje nga pika I dhe dokumentacionin teknik.

III. Objekti nga pika I. e këtij Vendimi mund të përdoret dhe shfrytëzohet nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi.

IV. Ky Vendim do të shërbejë si bazë për regjistrimin e objekteve të përshkruar në pikën I të këtij Vendimi në evidencat përkatëse kadastrale.

A r s y e t i m

Pronarët Habib Leci, Hasim Dërmaku, Jahir Ahmeti, Sebush Dërmaku, Hasan Dërmaku, Habim Dërmaku, Naim Murati, Qamil Hajrizi, Agron Stublla, Fadil Grajcevci, Feti Gashi dhe Hysen Hajdini nga Prishtina, me investitor "Pozhegu Brothers" me kërkesën nr. 05-392-224207 dt. 05.09.2016 i është drejtuar kësaj Drejtorie për lëshim të lejes së përdorimit për objektin afarist banesor C11/A/1 në kuadër të bllokut urbanistik "C11" të Planit Rregullues "Mati 1" konkretisht në kuadër të pjesës së parcelave të bashkuara (nr. 824/2,824/14,824/21,826/1,826/3,826/4,826/5,826/6,826/7,826/8,826/9,827/1,827/2,827

/3, 827/4,830/17,830/18 dhe 830/19 ZK Matiçan) të bllokut "C11" të ndërtuara sipas Aktvendimit nr. 05-351-32959, dt. 01.10.2012 të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit e Komunës së Prishtinës, me ç'rast ka dorëzuar këtë dokumentacion:

- o Procesverbalin mbi kontrollimin teknik të objektit investues të muajit Qershor 2016 nga komisioni profesional i emëruar nga kjo Drejtoria sipas Vendimit nr. 05-391-175303. dt. 20.08.2014 përkatësisht konkluzionit nr. 05-391-175303 dt. 29.03.2016 të lëshuar nga DUNMM.
- o Dokumentacionin përcjellës, kopjen e planit, certifikatën e njësisë kadastrale, atestet e materialeve, certifikatat, etj.

Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, pas shqyrtimit të provave të lëndës e konkretisht, procesverbalin e komisionit për kontrollim teknik të muajit Qershor 2016, ku secili anëtar ka bërë kontrollimin teknik të objekteve ndërtimore investuese dhe kanë konstatuar se objekti investues është ndërtuar në pajtim me vendimet e lartë cekura dhe dokumentacionin tjetër teknik dhe se i njëjti përmbushë normativat dhe standardet, aplikimi i të cilave është i domosdoshëm me rastin e ndërtimit të objekteve të tilla, për çka edhe ka propozuar që Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, t'i lëshoj lejen e përdorimi, andaj kjo Drejtoria vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Udhëzimi juridik: Kundër këtij Vendimi mund të paraqitet ankesë Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, përmes kësaj Drejtorie në afat brenda prej 30 ditësh duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij Vendimi.


I dorëzohet: Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, në lëndë dhe Qendrës për shërbim me qytetar.

DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS

05 nr. 392-224207 dt. 13.12.2016

E punoi:

Armend Mujaj, msc. i dipl. ndërt.



E kontrolloi:

Nazife Krasniqi, ida. i dipl.

